



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 6 Mars 2022

Nr: 136

URDHËR

PËR

**DISIPLINIMIN DHE VAZHDIMIN NË MËNYRË TË PANDËRPRERË TË PROCESIT TË
NUMËRIMIT TË TË GJITHA KUTIVE TË VOTIMIT TË PRANUARA TË RREGULLTA
NGA KZAZ-TË PËR ZGJEDHJET E PJESSHME TË DATËS 6 MARS 2022**

Në mbështetje të pikës 1, shkronja “b”, dhe pikës 2, të nenit 19, e nenit 32, pikat 1, shkronja “a”, dhe 3, nenit 33, shkronjat “a” dhe “ë”, nenit 119, pika 5, neni 168 dhe nenit 171, pika 5, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe vendimit nr. 21, datë 18.2.2022, të Komisionit Rregullator, “Për organizimin e punës në vendin e numërimit të votave, radhën e veprimeve gjatë dorëzimit të materialeve zgjedhore, numërimit të votave dhe nxjerrjes së rezultatit të zgjedhjeve për zonën e administrimit zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme për kryetar në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë që do të zhvillohen me datë 6 Mars 2022”,

URDHËROJ:

1. Komisionet e Zonës së Administrimit të Zgjedhjeve (KZAZ) të garantojnë administrimin dhe zhvillimin e procesit të numërimit të votave pa ndërprerje sipas dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe akteve nënligjore të nxjerra nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ-ja). Veprimet apo mosveprimet që ndikojnë në ngadalësimin e procesit të numërimit, konsiderohen shkelje e pikës 5, të nenit 119, të Kodit Zgjedhor dhe përbëjnë vepër penale në përputhje me nenin 248, të Kodit Penal.
2. KZAZ-të, pas administrimit të kutive të votimit të pranuar të rregullta, fillojnë menjëherë procesin e numërimit të votave. Me qëllim garantimin e vazhdimin të pandërprerë të procesit të numërimit, KZAZ-të duhet të organizojnë me grafikë shpërndarjen e punës midis grupeve të para dhe të dyta të numërimit, sipas përcaktimeve të nenit 2 të vendimit 21/2022 të Komisionit Rregullator.



Data: 6 Mars 2022

Nr. 136

“Për disiplinimin dhe vazhdimin në mënyrë të pandërprerë të procesit të numërimit të të gjitha kutive të votimit të pranuar të rregullta nga KZAZ-të për zgjedhjet e pjesshme të datës 6 Mars 2022”

3. Mospërbushja e detyrës së përcaktuar në pikën 2, ngarkon me përgjegjësi penale anëtarët dhe sekretarin e KZAZ-së. Në këto raste, kryesisht, KQZ-ja shkarkon anëtarin/ sekretarin e KZAZ-së dhe ndaj tyre, KQZ-ja dërgon menjëherë materialin kallëzues në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor përkatës.
4. KZAZ-ja të njoftojë menjëherë Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve për çdo parregullsi dhe problematikë që shfaqet, si dhe të përditësojë informacionin pranë KQZ-së për dinamikën e zhvillimit të procesit.
5. Ngarkohen KZAZ nr. 2, KZAZ nr. 3, KZAZ nr. 4, KZAZ nr. 5, të bashkisë Shkodër, Qarku Shkodër; KZAZ nr. 19, të bashkisë Dibër, Qarku Dibër; KZAZ nr. 21, KZAZ nr. 22, KZAZ nr. 23, KZAZ nr. 24, të bashkisë Durrës, Qarku Durrës; KZAZ nr. 26, të bashkisë Vorë, Qarku Tiranë; në KZAZ nr. 43 të bashkisë Rrogozhinë, Qarku Tiranë; dhe në KZAZ nr. 54 dhe KZAZ nr. 55 të bashkisë Lushnjë, Qarku Fier, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

